



4P564849-1

Kompleti i futjes së ajrit të freskët për kondicionerët Daikin
(pa ventilator tubi)

KDDP55D160-2

Manuali i montimit

LEXONI ME KUJDES KËTO INSTRUKSIONE PËRPARA MONTIMIT.
RUAJENI KËTË MANUAL NË NJË VEND PRAKTIK PËR TA PËRDORUR SI REFERENCË NË TË ARDHMEN.

Kujdes

Përpara se të nisni punën me montimin, lexoni me kujdes masat e sigurisë më poshtë dhe zbatojini ato për të garantuar sigurinë gjatë punës.

- Sigurohuni që të përdorni komponentët e dërguar ose të specifikuar për të montuar produktet. Në të kundërt, mund të ndodhë rrjedhje ajri ose produkti mund të rrëzohet.
- Pas montimit, kontrolloni nëse ka ndonjë gjë jonormale gjatë provës së funksionimit.

Tabela e kombinimit

Emri i kompletit	Emri i njësisë së brendshme dhe emri i panelit ku përdoret	
		Modeli
KDDP55D160-2	SPLIT	FCAG-B, FCAHG-H, FXFQ-B
	Paneli dekorativ	BYCQ140-E

Shënime

- Ky komplet mund të montohet kondicionerët e ajrit të llojit kasetë me montim në tavan.
- Përpara montimit, krahasoni emrin e njësisë së brendshme me referencën në tabelën më lart.
- Gjatë montimit referojuni edhe manualit të montimit të njësisë së brendshme, si dhe procedurës së montimit të panelit dekorativ.
- Kur instaloni një ventilator tubi, sigurohuni të përdorni një përshtatës të kabllot elektrike (EKRP1C12) dhe lidheni atë me ventilatorin e njësisë së brendshme.

KUJDES






Kontrolloni vëllimin e qarkullimit të ajrit të thithjes së njësisë së brendshme në mënyrë që të ngadalësohet më pak se 10%.






- Sigurohuni të instaloni grupin e sensorit të dërguar.
- Tubi i rekomanduar për lidhjen në terren tregohet në tabelën më poshtë.

Emri i pjesës	Numri i pjesës	
Tub fleksibël (Diametri normal D150)	K-FDS151D (1 m) K-FDS152D (2 m)	K-FDS153D (3 m) K-FDS154D (4 m)

Komponentët


Kontrolloni nëse kompleti juaj përfshin të gjitha pjesët më poshtë. (Pjesa në ngjyrë me hije është e paketuar më vete.)

Emri	Dhoma e thithjes	Dhoma e lidhjes (majtas)	Dhoma e lidhjes (djathtas)	Materiali izolues	Shirti thithës i lagështisë
Forma					
Sasia	1	1	1	2	2

Emri	Vidë	Grupi i sensorit	Fasheta	Vida (për sensorin)	Manuali i montimit (ky manual)
Forma	 M5×12				
Sasia	4	1	2	1	1

1. Zgjedhja e vendit dhe kapaku i aksesit

(1) Shihni figurën në vijim për të zgjedhur pozicionin e montimit (njësia matëse: mm).




*1. Varni dhe fiksoni grupin e tubit "T" për montimin. Peshja e grupit të tubit "T" mund të krijojë një hapësirë midis njësies së brendshme dhe dhomës së thithjes.

*2. Montoni dritaren e inspektimit (450 x 450 mm ose më shumë). Duhet instaluar secila nga dritaret e inspektimit.

Njësia e brendshme	Paneli dekorativ standard	Paneli dekorativ dizajner
SPLIT	A (mm)	
FCAG35-71B	264	306
FXFQ20-63B		
FCAG100-140B	306	348
FXFQ80-100B		
FCAHG71-140H	348	390
FXFQ125B		

(2) Montoni dritaren e inspektimit (njësia matëse: mm).





2. Montimi i grupit të sensorit dhe dhomës së thithjes

Pasi të jetë montuar njësia e brendshme, kryeni veprimet më poshtë në përputhje me masat paraprake në vijim.

- Sigurohuni të shkëputni energjinë elektrike përpara nisjes së punës.
- Çmontoni panelin dekorativ nga njësia e brendshme. (Për detajet jeni të lutur të shihni manualin e montimit të ofruar me panelin dekorativ.)

Montimi i grupit të sensorit

1. Shihni manualin e përdorimit të njësies së brendshme, për të hequr kapakun e bllokut të kontrollit të njësies së brendshme.
2. Montoni grupin e sensorit në vrimën konike të njësies së brendshme duke përdorur vidat e ofruara.
3. Hiqni bashkuesin (X16A) të sensorit ekzistues nga qarku i stampuar i njësies së brendshme.
4. Lidhni pajisjet e kablos së grupit të sensorit që ishte e kapur në njësinë e brendshme në bashkuesin (X16A) në qarkun e stampuar të njësies së brendshme.
5. Përdorni fashetat e ofruara për të fiksuar pajisjet e kablos (në pajisjen tjetër të kablos) siç tregohet në figurën më poshtë.
6. Pasi të ketë përfunduar e gjithë puna për lidhjet e instalimit elektrik, montoni kapakun e kutisë së kontrollit në përputhje me manualin e montimit të ofruar me kondicionerin.



Montimi i dhomës së thithjes

Figura tregon procedurën e montimit për një njësi të brendshme të re.

1. Ngjitni shiritin thithës të lagështisë në materialin izolues të daljes së ajrit në cep, dhe më pas futini ato në daljen e ajrit të njësies së brendshme. (2 pozicione) Fig. 1, Fig. 2.
2. Montoni dhomën e thithjes në njësinë e brendshme duke përdorur grepat fiksues (4 pozicione). Fig. 3, Fig. 5.
3. Mbërtheni grepat fiksues në katër pozicionet sipas referencës në fig. 4.
4. Montoni njësinë e brendshme dhe dhomën e thithjes ndërkohë që përputhni buzët e tyre në vijë të drejtë. Fig. 4, Fig. 6.

Fig. 1 Dalja e ajrit




Fig. 3




Fig. 4 Montimi





Fig. 5 Pas montimit






Fig. 6 Fotoja e montimit të përfunduar



3. Montimi i njësive së brendshme dhe dhomës së thithjes

- Montoni njësinë e brendshme dhe dhomën e thithjes. Për montimin ndiqni instruksionet në manualin e montimit të ofruar me njësinë e brendshme (shihni figurën djathtas për lartësinë e montimit.).
- Për të montuar dhomën e thithjes në një njësi të brendshme ekzistuese, ndryshoni lartësinë e montimit të njësive së brendshme në dimensionin "A" në figurën djathtas.




Paneli dekorativ standard	A=185 mm
Paneli dekorativ dizajner	A=227 mm

4. Montimi i dhomës së lidhjes dhe lidhja e tubit fleksibël


Montoni dhomat e lidhjes. (Një dhomë në secilën anë, 2 në total) Fig. 7.

1. Shtyni lart vrimat katrore të dhomës së lidhjes (majtas) ose (djathtas), ndërkohë që i kapni ato te grepi fiksues (gjuhëza) i dhomës së thithjes (2 pozicione).
2. Fiksioni dhomën e lidhjes duke përdorur vidat M5 të ofruara. (2 pozicione).

Fig. 7 Montimi i dhomës së lidhjes (kjo figurë tregon dhomën e lidhjes majtas.)



Montimi i dhomës së lidhjes (kjo figurë tregon dhomën e lidhjes majtas)



5. Lidhja e tubit <Tubi: diametri Ø150>

1. Lidhni tubin në dhomën e lidhjes.
(Futni tubin në skajin e pjesës si tub të dhomës së lidhjes.)
2. Lidhni pjesët e bashkuara me shirit dhe mbështilleni me izolant për të parandaluar rrjedhjen e ajrit.
3. Bëni izolimin termik të tubit për të parandaluar kondensimin.
4. Sigurohuni që tubi "T" është varur, fiksuar dhe izoluar siç duhet. Në të kundërt mund të ndodhë rrjedhje ajri.

KUJDES


- Zbatoni ligjet ose rregulloret lokale në fuqi për montimin e tubit.
- Në rast tubi metalik depërton përmes muresh prej druri, sigurohuni që të garantoni izolimin elektrik të tubit dhe të murit.
- Në pjesën e jashtme, montojeni tubin me pjerrësi për poshtë, në mënyrë që shiu të mos futet brenda tubit. (Pjerrësia 1/100~1/50)
- Aty ku tubi ka kontaktin me ajrin jashtë, vendosni rrjeta për të parandaluar që zogjtë, kafshët e vogla apo insektet të futen brenda tubit.
- Aty ku tubi ka kontaktin me ajrin jashtë, sigurohuni të montoni filtër ajri për të mbrojtur shkëmbyesin e nxehtësisë së njësisë së brendshme.

Mos kryeni me tubin veprimet e mëposhtme:



6. Montimi i panelit dekorativ dhe dhomës së thithjes

- Pasi paneli dekorativ të jetë montuar përkohësisht, instaloni pajisjet duke i kaluar nga paneli dekorativ përmes vrimës për instalimet elektrike të dhomës së thithjes. Mblidhni së bashku me fashetë pajisjet e kabllot së motorit rrotullues dhe pajisjet e kabllot së sensorit.
- Montoni panelin dekorativ në përputhje me instruksionet në manualin e montimit të ofruar me panelin dekorativ (Hiqni kapakun e kutisë së kontrollit.)
- Pasi të keni lidhur pajisjet e kabllot, montoni kapakun e kutisë së kontrollit. Gjatë montimit bëni kujdes që kapaku të mos kapë kabllot.



Kondicionerët e ajrit me valë

- Për detajet e procedurës së lidhjes shihni manualin e montimit të ofruar me kompletin e pultit të komandimit me valë (ofrohet më vete)

DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.

U Nové Hospody 1/1155, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium